



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



THIRRJA PËR APLIKIM

Përkrahje e fermerëve për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore

Zhvillimi i bujqësisë intensive është thujtë i pamundur të realizohet pa një sistem të mirë të ujitjes dhe burime të mjaftueshme të ujit, andaj është synim dhe objektiv i Komunës së Prishtinës rritja e sipërfaqeve bujqësore me sistemin e ujitjes.

Duke pasur për bazë këtë fakt, janë planifikuar mjete buxhetore nga ana e Komunës, ku do të përkrahen fermerë, të cilët kanë të mbjellë sipërfaqe bujqësore me perime dhe pemë.

Do të përkrahen fermerë, të cilët mbjellin perime (spec, domate, tranguj) në fushë të hapur, në sipërfaqe prej 0.25 ha deri në 1.00 ha, dhe në ambient të mbyllur – serra, në sipërfaqe nga 0.03 ha deri në 0,20 ha.

Do të përkrahen edhe fermerët që kanë të mbjellë pemë, në sipërfaqe nga 0.30 ha deri në 1.00 ha.

Kjo përkrahje do përfshijë sistemin e ujitjes, si dhe sigurimin e burimit të ujit (hapjen e pusëve). Fermerët do të përkrahen vetëm me sistem të ujitjes ose me sigurimin e burimit të ujit.

Vlera e përkrahjes me sistem të ujitjes do jetë në proporcion me sipërfaqet e mbjella me kulturat që janë planifikuar të përkrahen, duke marrë për bazë çmimin e tregut të sistemit të ujitjes.

Vlera e përkrahjes për sigurimin e burimit të ujit - hapjen e pusit, do varet nga thellësia e pusit dhe mund të arrijë më së shumti në 1,000.00€, ndërsa pjesën tjetër do ta mbulojë aplikuesi - fermeri.

Investimet fillimisht duhet të bëhen nga fermeri, pastaj pas përfundimit të investimeve, do të bëhet pagesa në bazë të specifikave përkatëse.

KRITERET E PËRGJITHSHME

Kriteret e përcaktuara për përkrahje me sistem të ujitjes pikë-pikë

- Aplikuesi të ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës dhe të jetë banor i saj;
- Sipërfaqja e mbjellë me pemë duhet të jetë nga 0,30 - 1,00 ha;
- Sipërfaqja e mbjellë me perime në ambient të hapur, duhet të jetë nga 0,30 - 1,00 ha;
- Sipërfaqja e mbjellë me perime në ambient të mbyllur, duhet të jetë nga 0,03 - 0,20 ha;
- Fermerët të cilët janë përfitues të grantit “Përkrahja me mjedër 2015”, nuk mund të jenë përfitues të përkrahjes me sistem të ujitjes pikë-pikë.
- Përparësi do të kenë fermerët që kanë të mbjellë sipërfaqe më të madhe me pemë dhe perime

Kriteret e përcaktuara për përkrahje me sigurimin e burimit të ujit - hapjen e pusit

- Do të përkrahen fermerët për hapjen e pusit në thellësi deri në 25 m;
- Fermerët duhet të kenë të mbjellë sipërfaqe së paku 0,30 - 1,00 ha me pemë, së paku 0,30-1,00 ha sipërfaqe të mbjellë me perime në ambient të hapur, ose së paku 0,03-0,20 ha sipërfaqe të mbjellë me perime në ambient të mbyllur.
- Përparësi do të kenë fermerët që kanë të mbjellë sipërfaqe më të madhe me pemë dhe perime

FURNIZIM ME SISTEM TË UJITJES PIKË-PIKË – KRITERET SPECIFIKE

Sistemi i ujitjes pikë-pikë – perime (fushë e hapur), në sipërfaqe 1 ha

Gyp furnizues Φ - 40(5/4)	100m
Gyp furnizues Φ – 16/2	16000m
Filter 5/4	1 copë
Gjysmëlidhëse 5/4	1 copë
Ventil 5/4	1 copë
Mbyllës 5/4	1 copë
Ventila pikë-pikë	160 copë
Mbyllëse pikë-pikë	160 copë
Vazhduese	10 copë
“T” vazhduese	10 copë

Sistemi i ujitjes pikë-pikë – perime (ambient të mbyllur - serra), në sipërfaqe 0,20 ha.

Gyp furnizues Φ - 40(5/4)	20m
Gyp furnizues Φ – 16/2	3200m
Filter 5/4	1 copë
Gjysmëlidhëse 5/4	1 copë

Ventil 5/4	1 copë
Mbyllës 5/4	1 copë
Ventila pikë-pikë	32 copë
Mbyllëse pikë-pikë	32 copë
Vazhduese	10 copë
“T” vazhduese	10 copë

Sistemi i ujitjes pikë-pikë - pemë të imëta, në sipërfaqe 1 ha

Gyp furnizues Φ - 40(5/4)	100m
Gyp furnizues Φ – 16/2	3500m
Filter 5/4	1 copë
Gjysmëlidhëse 5/4	1 copë
Ventil 5/4	1 copë
Mbyllës 5/4	1 copë
Ventila pikë-pikë	35 copë
Mbyllëse pikë-pikë	35 copë
Vazhduese	10 copë
“T” vazhduese	10 copë

Sistemi i ujitjes pikë-pikë – pemë, në sipërfaqe 1 ha

Gyp furnizues Φ - 40(5/4)	100m
Gyp furnizues Φ – 16/2	3500m
Filter 5/4	1 copë
Gjysmëlidhëse 5/4	1 copë
Ventil 5/4	1 copë
Mbyllës 5/4	1 copë
Ventila pikë-pikë	35 copë
Mbyllëse pikë-pikë	35 copë
Vazhduese	10 copë
“T” vazhduese	10 copë
Pikatorë	1800 copë

Dokumentacioni i nevojshëm

- Kërkesa për aplikim,
- Kopja e një dokumenti identifikues,
- Kopja e kartelës së vlefshme bankare,
- Certifikata mbi pronësinë e tokës jo më e vjetër se një vit.

Afati i aplikimit: 24.7.2015 – 31.7.2015